



Syri i Vizionit

NDËRGJEGJËSIMI I PUNËTORËVE PËR TË DREJTAT E TYRE DHE REGJISTRIMI NË SINDIKATA

SYRI I VIZIONIT
MAJ, 2016

PËRMBAJTJA:

Përmbledhja ekzekutive.....	3
Metodologjia.....	5
Të gjeturat.....	6
Rekomandimet.....	17
Anexi: Pyetjet.....	18

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Organizata jo qeveritare Syri i Vizionit në kuadër të projektit "Qytetaria Aktive" mbështetur financiarisht nga Olaf Palme Internacional Center dhe SIDA-së, ka realizuar një hulumtim në Komunën e Pejës lidhur me ndërgjegjësimin e punëtorëve mbi të drejtat e tyre në punë apo si punëtor qoftë në sektorin publik dhe atë privat, si dhe regjistrimin e tyre në sindikata.

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë nxjerrja në pah e njohurive të punëtorëve mbi të drejtat e tyre në vendet e punës sipas ligjit të punës dhe njohurive që ata kanë në lidhje me ekzistimin dhe zbatimin e këtij ligji nga ana e punëdhënësit të tyre, në të dy sektorët, atë privat dhe publik, sektor të ndryshëm që rregullon ligji i punës, si orarin e punës, sigurimet shëndetësore, të drejtën e pushimit vjetor, kontratat dhe çështje tjera të rëndësishme që rregullon ligji i punës Nr. 03/L-212.

Po ashtu, hulumtimi ka nxjerrë në pah edhe njohuritë e punëtorëve lidhur me punën dhe misionin e sindikatave të punëtorëve, rolin e këtyre sindikatave në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, kushtet e punës në vendet e punës si dhe besueshmërinë që kanë punëtorët në këto sindikata për të qenë anëtarë të tyre.

Në këtë hulumtim janë përfshirë gjithsejtë 215 respondentë të punësuar në sektorin privat dhe atë publik, nga të dy gjinitë meshkuj dhe femra, nga mosha 18-65 vjeç siç përcakton edhe ligji i punës.

Bazuar në rezultatet e hulumtimit, diku mbi 80% e respondentëve në sektorin privat dhe 90 % në sektorin publik kanë njohuri që ekziston Ligji i punës. Pavarësisht një numri të madh të përgjigjeve që pretendojnë se dinë për Ligjin e Punës, përgjigjet në vazhdim tregojnë se megjithatë ata nuk e dinë brendinë e tij, ose nuk dinë të kërkojnë të drejtat e tyre sipas këtij ligji, prandaj në këtë rast përgjigjet duhen kuptuar si njohuri që kaun ata që ekzistoj një ligj i tillë, por jo domosdo se njohin përmbajtjen e tij dhe të drejtat që ai u garanton.

Sa i përket trajtimit të barabartë në vendet e tyre të punës, respondentët nga të dy sektorët,ose mbi 61% e tyre theksojnë se kanë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues, ndërsa pjesa tjetër thonë që ka raste të diskriminimit dhe nuk ka dallime në sektorin publik me atë privat.

Lidhur me pyetjen rreth regjistrimin të punëtorëve në sindikata, tek respondentët e punësuar në sektorin privat vërehet se te ata nuk kanë shumë njohuri mbi misionin e sindikatave pasi që 75% prej tyre nuk janë të regjistruar në sindikata, ndërsa 18% e tyre janë të regjistruar dhe pjesa tjetër diku 7% nuk kanë dashur të përgjigjen. Në anën tjetër,në sektorin publik të punësuarit kanë shumë më shumë njohuri dhe besueshmëri në sindikata dhe se 74% të intervistuarve deklarojnë se janë të regjistruar në sindikata, ndërsa 25% nuk janë të regjistruar, kurse pjesa tjetër diku 1% nuk kanë dashur të përgjigjen.

Sa i përket mbështetjes së qeverisë në respektimin e të drejtave të punëtoreve në vendet e tyre të punës, 55% e respondentëve në sektorin publik deklarojnë se qeveria respekton të drejtat e tyre deri në një masë, 14% deklarojnë se qeveria mbron të drejtat e tyre në rastet më të shpeshta, pjesa tjetër apo 24% deklarojnë se qeveria respekton shumë pak apo aspak të drejtat e tyre si punëtor.

Ne anën tjetër, në sektorin privat 36% e respondentëve deklarojnë se qeveria mbështet respektimin e të drejtave të tyre në vendet e punës, ndërsa 35% deklarojnë se qeveria aspak nuk mbron të drejtat e tyre, kurse një numër shumë i vogël kanë deklaruar se ka raste kur qeveria mbështet të drejtat e punëtorëve, , ndërsa 3% e respondentëve nuk kanë dashur të përgjigjen fare.

Si përfundim, hulumtimi lë të kuptojë se në sektorin privat ka më shumë nevojë për të ngritur njohuritë e punëtorëve për rolin dhe rëndësinë e sindikatave duke mos anashkuar nevojën e informimit të punëtorëve në sektorin publik edhe pse në masë më të vogël. Gjithashtu, qeveria dhe institucionet relevante duhet të bëjë ndërmarrin hapa serioz që të sigurojnë zbatimin e ligjit të punës sidomos në sektorin privat, për të siguruar që punëtorët në këtë sektor gëzojnë të drejtat e punëtorëve në vendet e tyre të punës ashtu si parasheh ligji.

METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij hulumtimi, SiV fillimisht ka analizuar Ligjin e punës Nr. 03/L-212, aktet tjera nënligjore që dalin nga ky ligj i punës, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë më themelimin, rolin dhe përgjegjësit e sindikatave të punëtorëve.

Pasi është bërë analiza e akteve ligjore në këto dy sektorë, është vendosur për metodologjinë e hulumtimit, përcaktimit të numrit të respondentve dhe zonës gjeografike që do të mbulon hulumtimi. Në hulumtim janë përfshirë gjithsejtë 215 respondentë, pak a shumë në një shifër të përafërt sa nga sektori privat aq edhe nga sektori publik, përkatësisht 110 të punësuar në sektorin privat dhe 105 nga sektori publik. Gjithashtu, hulumtimi ka ndjekur edhe një kuotë gjinore të respondentëve, me një përqindje pak a shumë të barabartë, pasi 109 të intervistuar kanë qenë femra (nga to të punësuar në sektorin publik kanë qenë 53, kurse në atë privat 56) dhe 107 meshkuj (prej tyre 52 në sektorin publik dhe 54 në sektorin privat). Hulumtimi ka intervistuar respondentët nga mosha 18-65 vjeç.

Pasi janë përcaktuar këto mostra, është hartuar pyetësori, i cili ka 20 pyetje me mënyra të ndryshme përgjigjeje, disa përgjigje me llojet e përgjigjeve po ose jo, disa me opsione për të zgjedhur përgjigjen, kurse në një pjesë është dhënë mundësia për të dhënë informacione shtesë në përgjigje. Hulumtimi është ka qenë anonim dhe qytetarët nuk janë pyetur për të dhënat personale, as për vendin e punës, përveç pyetjes nëse janë të punësuar në sektorin privat a publik. Për të mos ndikuar në rezultate, pyetësorët janë shpërndarë dhe intervistimi është kryer nga vullnetarë të Syri i Vizionit, të rinj që nuk janë të angazhuar permanent në organizatë. Para se të fillojë administrimi i pyetësorit, në terren nga ana e vullnetarëve janë identifikuar institucionet publike të hulumtimit në komunën e Pejës si Administrata komunale, Shëndetësia, Arsimi, gjykata dhe prokuroria, PTK, ATK, etj. Ndërsa në sektorin privat janë përzgjedhur ndërmarrje të mëdha, të mesme dhe të vogla, kompani sigurimi fizik, ndërmarrje ndërtimtarie, banka, etj.


I gjithë hulumtimi është realizuar në komunën e Pejës, mirëpo janë përfshirë respondentët që punojnë në sektorin publik dhe privat edhe në zonat rurale/fshatra jo vetëm në qytetet.

TE GJETURAT


Pyetja e parë e parashtruar ka qenë lidhur me njohuritë për Ligjin e punës. Në pyetjen se ata dinë për ligjin e punës, 88% e të anketuarve nga sektori privat në shumicë absolute janë përgjigjur pozitivisht, vetëm 9% nuk dinë për ligj, ndërsa 3% nuk kanë pasur ndonjë përgjigje. Shih Fig. 1.

Në anën tjetër, nga sektori publik 91% e të anketuarve janë përgjigjur se dinë për ligjin e punës, 1% janë përgjigjur se nuk dinin për ligjin e punës dhe 8% nuk janë përgjigjur fare. Shih Fig.2.

Sektori privat Fig.1.



Sektori publik Fig.2.




Pavarësisht një numri të madh të përgjigjeve që pretendojnë se dinë për Ligjin e Punës, përgjigjet në vazhdim tregojnë se megjithatë ata nuk e dinë brendinë e tij, ose nuk dinë të kërkojnë të drejtat e tyre sipas këtij ligji, prandaj në këtë rast përgjigjet duhen kuptuar si njohuri që kaun ata që ekzistoj një ligj i tillë, por jo domosdo se njohin përmbajtjen e tij dhe të drejtat që ai u garanton.


Në pyetjen e radhës: Nëse dini për ligjin, si keni mësuar për të? 36% kanë deklaruar se ju a ka dhënë punëdhënësi kopjen e ligjit për të lexuar, 26% kanë deklaruar se e kanë gjetur ligjin në internet, 15% kanë deklaruar se kanë dëgjuar se ekziston, 8% kanë dhënë shpjegime të ndryshme ose janë deklaruar se janë informuar në forma tjera dhe 15% nuk kanë pasur përgjigje Shih Fig.3.

Sa i përket sektorit publik i janë përgjigjur kësaj pyetje me 36% e tyre që e kanë gjetur në internet, 45% kanë deklaruar se ligjin iu kishte dhënë punëdhënësi kopje, 11% janë deklaruar se vetëm kanë dëgjuar që ekziston, 4% japin sqarime dhe 4% nuk kanë pas përgjigjeje. Shih Fig.4.

Sektori privat Fig.3.




Sektori publik Fig.4.




Në pyetjen: A ju njihet e drejta e pushimit vjetor? Nëse po, sa ditë pushim vjetor merrni? Punëtorët e sektorit privat kane deklaruar se 69% marrin pushim nga dy javë, 19% e responentëve kanë deklaruar se e shfrytëzojnë pushimin katër javor, kurse vetëm 4% marrin më shumë se katër javë pushim vjetor, poashtu 4% tjetër marrin pushim vetëm 5 ditë si pushim vjetor dhe 4% nuk kanë patur përgjigje. Shih Fig.5.

Ndërsa në sektorin publik për pyetjen e njëjtë se: A ju njihet e drejta e pushimit vjetore, dhe sa ditë nga pushimi vjetor shfrytëzojnë? Ata deklarojnë se 14% e shfrytëzojnë pushimin vjetor prej dy javësh, 66% marrim pushim prej katër jave në vit, 15 % më shumë se katër jave, 4% nga te anketuarit e sektorit publik nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje dhe 1% marrin pushim vetëm pesë ditë. Shih Fig. 6.

Sektori privat Fig.5



Sektori publik Fig.6




Në pyetjen tjetër: Sa është kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes tuaj me punëdhënësin? Punëtorët e anketuar nga sektori privat janë deklaruar me 1% me kontratë një mujore, 9% një


deri në tre muaj, 25% e të punësuarve në sektorin privat kanë kontratë gjate mujore, 36% janë me kontrate njëvjeçare, 25% kanë kontrate për me shume se një vite dhe 4% nga te anketuarit nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig.7.

Pyetja për kontratat e punës në sektorin publik na jep krejtësisht rezultate tjera në krahasim me sektorin privat, dhe atë si në vijim: 3% e të anketuarve deklarojnë se kanë kontratë gjashte mujore, 9 % janë me kontratë një vjeçare , ndërsa pjesa dërmuese e te anketuarve në sektorin publik kanë me kontrata apo marrëveshje pune për me shume se një vit, 1% nuk janë përgjigjur për kontratën e punës, 0% vjen për kontrata një mujore dhe poashtu 0% për ata me kontrata një deri në tre muaj. Shih Fig.8.

Sektori privat Fig.7




Sektori publik Fig. 8




Në vazhdim pyetja: A konsideroni se trajtoheni të barabartë në vendin e punës? sektori privat deklaron se 3% aspak te barabarta, 4% konstatojnë se janë jo edhe aq te barabartë, 5% nuk kane opinion, 25% vlerësojnë se deri diku janë te barabarte, poashu pjesa me e madhe e te anketuarve vlerësojnë se trajtohen shume shpesh te barabarte dhe vetëm 2% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig. 9.

Ndërsa sektori publik për pyetjen e njëjtë se: A konsideroni se trajtoheni te barabarte në vendin e punës? deklaron se 1% vlerëson se aspak nuk ndjehen te barabarte, 4% jo edhe aq të barabartë, 4% e pjese tjetër e te anketuarve nuk kane opinion lidhur me këtë pyetje, 27 % vlerësojë se deri diku trajtohen njëjte, ndërsa pjesën me te madhe në këtë vlerësim për trajtimin e barabarte e përben 62%. Shih Fig.10.

Sektori privat Fig. 9




Sektori publik Fig. 10




Për pyetjen: Ku qëndrojnë arsyet të mosbarazisë në vendin e punës? del se 23% se nuk ka mbrojtje dhe siguri në pune, pjesën me të madhe prej 47% e përbën mosbarazia në orarin e punës sipas të anketuarve në sektorin privat, 18% vlerësojnë pabarazi në pushime dhe 12% mendojnë se kontratat janë të pavlefshme. Shih Fig.11.

Përgjigjet për pyetjen: Ku qëndron arsyeja për mosbarazi në vendin e punës? tek sektori publik del me ndryshe krahasuar me sektorin privat dhe rezulton me 80% e të anketuarve deklarojnë mosbarazi në mbrojtjen dhe siguri në pune, 13% deklarojnë si arsyetim për mosbarazi në vendin e punës orarin, 7% mendojnë se kontratat janë të pavlefshme Shih Fig. 12.

Sektori privat Fig.11.



Sektori publik Fig.12.




Pyetja: A mendoni se qeveria është mbështetëse për të drejtat e punëtorëve? anketuesit e sektorit privat përgjigjen me 35% se aspak nuk mendojnë se mbështetën nga qeveria, 16% jo edhe aq, 5% nuk kane opinion, 36% vlerësojnë qe qeveria i mbështet deri diku, 5% mendojnë se shume shpesh dhe 3% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig.13.


Nga ana tjetër, në pyetjen e njëjte të anketuarit e sektorit publik deklarojnë se 11% mendojnë se aspak nuk mbështetën nga qeveria, 13% jo edhe aq, 6% nuk kane opinion, 55% pra pjesa me e

madhe e përgjigjeve në këtë pik mendojnë se mbështetën nga qeveria deri diku, 14% vlerësojnë se shume shpesh mbështetën nga qeveria dhe 1% nuk përgjigjen fare. Shih Fih.14.

Sektoti privat Fig .13.




Sektori publik Fig.14.




A ju ofrohet mbrojtja shëndetësore në pune? Sektori privat prej 51% deklarojnë me po, ndërsa 47% deklarohen me jo dhe 2% nuk përgjigjen. Shih Fig.15.

Në anën tjetër punëtorët e sektorit publik për pyetjen: A ju ofrohet mbrojtje shëndetësore në pune? përgjigjen me 11% po, dhe në pjesën me të madhe prej 81% me jo si edhe 8% që nuk japin përgjigjeje. Shih Fig.16.

Sektori privat Fig.15.




Sektori publik Fig.16.




Në pyetjen: A jeni udhëzuar prej punëdhënësit që të bëni sigurimin shëndetësor? në sektorin privat del se 44% kane deklaruar me po, ndërsa 41% me jo, që nuk janë udhëzuar nga punëdhënësi dhe 15% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig.17.

Kurse në sektorin publik te anketuarit janë përgjigj se 10% me po, 57% me jo dhe 33% që nuk përgjigjen në këtë pyetje. Shih Fig.18.

Sektori privat Fig.17.




Sektor publik Fig.18.




Kush e bën pagesën e sigurimit shëndetësor? Punëtorët në privat deklarojnë se 9% i mbulojnë vet shpenzimet e sigurimit, 47% deklarojnë se një pjesë për pagesën e sigurimit shëndetësor e mbulojnë vet dhe një pjesë punëdhënësi, ndërsa pjesa tjetër që përbehet nga 44% kompania i mbulon tere shpenzimet për sigurimin shëndetësor Shih Fig.19.

Kurse sektori publik prej 47% i mbulojnë shpenzimet e sigurimit vet, 20% e të intervistuarve thonë se një pjesë e paguajnë vet, dhe një pjesë kompania ndërsa 33% deklarojnë se kompania i mbulon shpenzimet e sigurimit shëndetësor. Shih Fig.20.

Sektori privat Fig.19.




Sektori publik Fig.20.




Në pyetjen e radhës: Në kontratën e nënshkruar me kompaninë a ka ndonjë nen në të cilin përshkruhet sigurimi shëndetësor? 33% e anketuesve te sektorit privat deklarojnë me po, 8% deklarohen me jo, 21% nuk e dine dhe 38% nuk janë përgjigjur. Shih Fig.21.

Sektorit publik në pyetjen e njëjtë janë përgjigjur 4% me po, 23% me jo, 10 nga këta nuk e dine nëse ka ndonjë nen në kontratë që përshkruan çështjen e sigurimit shëndetësor dhe 63% që është pjesa dërmuese nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje Shih Fig.22.

Sektori privat Fig .21.



Sektor publik Fig.22.




Në pyetjen: në raste të sëmundjes a keni kërkuar kompensimin nga kompania e sigurimeve shëndetësore për shpenzimet? Janë deklaruar 35% me po, 18% me jo dhe pjesa me e madhe e mbetur prej 47% nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig.23.

Në anën tjetër anketuesit e sektorit publik rezulton të jenë përgjigjur 8% me po, 24% me jo dhe pjesa dërmuese e të anketuarve nuk janë përgjigjur në këtë pyetje. Shih Fig. 24.

Sektori privat Fig.23.



Sektori publik Fig.24




Në pyetjen: Sa përqind e shumës totale të shpenzuar ju është kthyer? Shkruani përqindjen. Te anketuarit e sektorit privat me 3% deklarojnë për 0% kompensim, 22% pranojnë se 50% e shumës së shpenzuar iu është kompensuar nga kompanitë e sigurimeve, 3% deklarohen se 60% kanë marr kompensim për siguri shëndetësor, 36% kompensohen me 70%, ndërsa 33%


deklaron të jene kompensuar me 80% të shumës se shpenzuar dhe 3% i mbetur kompensohet me 100% të shumës se shpenzuar,nga kompania e sigurimeve shëndetësore. Shih Fig.25.

Sektori publik lidhur me këtë pyetje deklarojnë se 20% e të anketuarve kompensohen me 0% nga kompania e sigurimeve shëndetësore, poashtu 20% tjerë deklarojnë se kompensohen me 50% nga shuma e shpenzuar dhe 60% e të anketuarve në sektorin publik kompensohen me 100% nga kompanitë e sigurimeve shëndetësore për shpenzimet. Shih Fig. 26.

Sektori privat Fig.25.




Sektori publik Fig.26.




Për pyetjen: A ju ka ndodhur të lëndoheni në vendin e punës? Anketuesit privat thonë se 8% prej tyre po, janë lënduar në vendin e punës, ndërsa numri më i madh i të anketuarve apo 84% janë deklaruar me jo, poashtu 8% i mbetur nuk janë përgjigjur. Shih Fig.27.

Për lëndimet në vendin e punës si punëtorë të sektorit publik janë 9% që deklarohen me po, e që afërsisht është i ngjashëm me sektorin privat, ndërsa 71 % deklarohen me jo se nuk janë lënduar në vendin e punës që i bje te jetë përqindje më e vogël në krahasim me sektorin privat, po që pjesa e mbetur prej 20% që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje është poashtu më e madhe se në sektorin privat Shih Fig. 28.

Sektori privat Fig.27.




Sektori publik Fig .28.




A ju është ofruar sigurim për kompensimin e shpenzimeve? 53% e punëtorëve të sektori privat deklarojnë se po, dhe 47% përgjigjën me jo. Shih Fig.29.

Në po e njëjta pyetje, punëtorët e sektori publik me një dallim shume me te madhe që rezulton të jete 9% e tyre përgjigjën me po dhe pjesa tjetër prej 91% përgjigjën me jo. Shih Fig.30.

Sektori privat Fig.29.




Sektori publik Fig.30.




Në pyetjen: A ju ka ndodhur që të punoni me shume se 8 orë shtesë në jave jashtë orarit të parapare me marrëveshje /kontratë? Me shume se gjysma pra 59% e të anketuarve në privat janë deklaruar me po, se punojnë me shume sesa që është paraparë në marrëveshjen e tyre me punëdhënësin, ndërsa 38% përgjigjën me jo dhe 3% nuk përgjigjen fare. Shih Fig.31.

Në sektorin publik 46% përgjigjën me po, se punojnë jashtë orarit të paraparë me kontratë dhe 50% përgjigjën me jo, por nuk e kalojnë normën e punës të cilën e kanë në marrëveshje me punëdhënësin dhe 4 % nuk janë përgjigj. Shih Fig.32.

Sektori privat Fig.31.




Sektori publik Fig .32.




Për pyetjen: A është shpallur orari i punës në vend të dukshëm në vendin tuaj të punës? Pjesa me e madhe pra 74% e punëtorëve të sektori privat deklarojnë me po ndërsa 24 % përgjigjën me jo dhe 2% pa përgjigje. Shih Fig.33.

Anketuesit e sektorit publik për pyetjen e njëjtë se: A është i shpallur orari i punës në vend të dukshëm në vendin tuaj të punës ? kane deklaruar me një numër shume i madhe prej 91% me po, 8% me jo dhe 1% pa përgjigje. Shih Fig.34.

Sektori privat Fig.33.




Sektori publik Fig.34.



Pyetja: A ju ka ndodhur qe sindikatat të mbrojnë të drejtat tuaja në gjykata? Vetëm 13% nga sektori privat janë deklaruar me po, 77% janë deklaruar me jo dhe 10 % nga ta nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje. Shih Fig.35.

Ne anën tjetër punëtorët e sektorit publik për pyetjen e njëjtë, thonë se 11% prej tyre po, 86% i janë përgjigjur me jo, dhe 3% pa përgjigjeje. Shih Fig.36.

Sektori privat Fig.35.



Sektori publik Fig.36.



Në pyetjen: A e dini ndonjë rast kur sindikatat kane mbrojtur të drejtat e punëtorëve? Punëtorët privat prej 48% janë përgjigjur me po, ndërsa 45% me jo dhe 7% e tyre pa përgjigjeje Shih Fig.37.

Kur behet fjalë që sindikatat te mbrojnë të drejtat e punëtorëve të sektorit privat,atëherë rezulton të jete se 74% janë deklaruar me po, ndërsa 25% me jo dhe vetëm 1% nuk janë përgjigj. Shih Fig.38.

Sektori privat Fig.37.




Sektori publik Fig.38.



Pyetja e radhës se: A jeni të regjistruar në sindikatë? Del që sektori privat te deklaroj me po vetëm 18% e tyre, ndërsa pjesa me e madhe prej 75% janë përgjigjur me jo dhe 7% nuk janë përgjigjur fare. Shih Fig.39.

Ndërsa në sektori publik rezulton krejtësisht e kundërta, ku 74% e të anketuarve deklarohen me po, 25% me jo dhe 1% nuk përgjigjen Shih Fig.40.

Sektori privat Fig.39.



Sektori publik Fig .40.



REKOMANDIMET:

- Qytetarët, e sidomos të punësuarit, kanë nevojë për njohuri më të madhe lidhur me Ligjin e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet që parasheh ky ligj ndaj punëdhënësit dhe të punësuarit;
- Inspektoriati i punës duhet të inspektojë më shumë kompanitë private, e edhe ndërmarrjet apo institucionet publike, pasi që të punësuarit janë ankuar se ata shpesh diskriminohen në orar të punës, pasi ata punojnë edhe jashtë orarit pa ndonjë kompensim shtesë, dukuri më shumë e pranishme në sektorin privat, e në raste edhe në sektorin publik;
- Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të obligojë të gjitha bizneset dhe institucionet në sektorin publik dhe privat të ofrojnë materialet dhe mjetet e duhura për punë që rrit sigurinë e shëndetit dhe jetës së punëtorëve në vendet e tyre të punës pasi ky ka qenë një shqetësim i dal nga punëtorët në sektorin publik dhe privat;
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies dhe Inspektorati i punës duhet të inspektojë më shumë sektorin privat lidhur me hartimin dhe zbatimin e kontratave që ata lidhin me punëtorë, pasi që punëtorët diskriminohen sidomos në pushimin, ditor, javor dhe vjetor, por edhe në sektorin publik ka një shqetësim të tillë, edhe pse në përqindje më të vogël;
- Qeveria e Kosovës duhet hartojë politika vetëdijësuese që garanton mbrojtjen e punëtorëve dhe rrit besueshmërinë e tyre se është e angazhuar dhe angazhohet çdo ditë në mbrojtjen e të drejtave të tyre në punë;
- Qeveria, konkretisht Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me drejtoritë komunale të shëndetësisë, duhet të bëjnë më shumë që punëdhënësit në sektorin publik dhe privat t'u garantojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në rast të lëndimit apo helmimit në vendin e punës, duke përfshirë koston e shërimit dhe dëmshpërblimin;
- Sindikatat e punëtorëve duhet të vizitojnë bizneset e ndryshme për të bashkëbiseduar me punëtorë, për të rritur kështu besueshmërinë e punëtorëve në Sindikata si institucion që mbron interesat e punëtorëve, jo vetëm në vendin e tyre të punës, por edhe në Gjykata nëse ka nevojë;
- Sindikatat duhet zhvillojnë një fushatë vetëdijësuese për procedurat dhe rendësin e regjistrimit apo anëtarësimit të punëtorëve sidomos atyre në sektorin privat në Sindikata;
- Sindikatat duhet të ndërmarrin aktivitet të ndryshme që ndikojnë në vetëdijësim e punëdhënësve mbi të drejtat e punëtorëve që ata duhet të gëzojnë në vendet e tyre të punës si në sektorin publik po ashtu edhe në atë privat;
- Sindikatat duhet të hartojnë plane për të rritur vetëdijen dhe besueshmërinë e punëtorëve në sindikata, posaçërisht në disa nga sindikatat më të vogla. Ato duhet të rrisin anëtarësinë dhe të shtojnë besimin se sindikatat mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe në sensibilizimin për mirëqenien e punëtorëve;
- Duhet të shtohet bashkëpunimi ndërsindikal, mes sindikatave më të mëdha dhe atyre më të vogla, për të ndihmuar fuqizimin e tyre me përvojat dhe bashkëpunimet që kanë.

ANNEX:

Pyetjet:

1. A dini për Ligjin e Punës?
2. Nëse dini për ligjin, si keni mësuar për të:
 - E keni gjetur në internet dhe e keni lexuar?
 - Ju ka dhënë punëdhënësi kopjen dhe e keni lexuar?
 - Keni dëgjuar se ekziston?
 - Jeni shpjegime
3. A ju njihet e drejta për pushim vjetor? Nëse po, sa dite pushim vjetor merrni?
4. Sa është kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes tuaj me punëdhënësin?
5. A konsideroni se trajtoheni të barabartë në vendin e punës?
6. Nëse jo, ku qëndrojnë arsyet e mosbarazisë në vendin e punës? Jepni shembuj.
7. A mendoni se shteti është mbështetës në realizimin e të drejtave tuaja të punës?
8. A ju ofrohet mbrojtja shëndetësore në punë?
9. A jeni udhëzuar prej punëdhënësit që të bëni sigurimin shëndetësor?
10. Nëse përgjigja është po, pagesën për sigurim shëndetësor kush e bën?
11. Në kontratën e nënshkruar me kompaninë a ka ndonjë nen në të cilën përshkruhet sigurimi shëndetësor?
12. Në rast të sëmundjes, a keni kërkuar kompensimin nga kompania e sigurimeve shëndetësore për shpenzimet?
13. Sa përqind e shumës totale të shpenzuar ju është kthyer? Shkruani përqindjen.
14. A ju ka ndodhur të lëndoheni në vendin e punës?
15. Nëse po, a ju është ofruar sigurimi për kompensimin e shpenzimeve?
16. A ju ka ndodhur që të punoni më shumë se 8 orë shtesë në javë jashtë orarit të paraparë me marrëveshje/kontratë?
17. A është i shpallur orari i punës në vend të dukshëm në vendin tuaj të punës?
18. A ju ka ndodhur që sindikata të mbrojë të drejtat tuaja në gjykatë?
19. A e dini se sindikatat mbrojnë anëtarët e vet nga punëdhënësi pranë gjykatave?
20. A jeni të regjistruar në sindikatë?



Ky publikim është pjesë e projektit "Qytetaria Aktive", i realizuar nga "OJQ Syri i Vizionit" nga "Peja", financuar nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme e mbështetur nga Qeveria Suedeze. Të gjitha përmbajtjet e këtij publikimi përfaqësojnë qëndrimet e autorëve dhe nuk reflektojnë medoemos mendimet e organizatës Ndërkombëtare Olof Palme.